

MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË BASHKINË KLOS

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Bashkinë Klos me objekt: Zbatimin e detyrave nga auditimi i mëparshëm; Menaxhimin financiar dhe auditimin e brendshëm; Hartimin dhe zbatimin e buxhetit të bashkisë; Zbatimit të dispozitave ligjore që rregullojnë marrëdhëniet e punës; Organizimit, mbajtjes së kontabilitetit, nxjerrjes së llogarisë vjetore, inventarizimit të pasurisë publike dhe administrimit dhe dokumentimit të vlerave monetare dhe materiale; Prokurimit të fondeve publike; Realizimit të ardhurave dhe tarifave vendore; Në fushën e urbanistikës; Administrimit të aseteve dhe procedurës së dhënies me qira të tyre; Organizimit dhe funksionimit të inspektoratit ndërtimor urbanistik; Organizimit e funksionimit të policisë bashkiake”.” dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 139 , datë 30.9.2012.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit", ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 01.06.2000, me shkresën nr. 577/9 , datë 30.9.2012 , dërguar z. **Ramazan Mjeshtri**, Kryetar i Bashkisë, krahas Raportit Përfundimtar të Auditimit, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Për implementimin e kërkesave të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, rekomandojmë;

-të rishikohet rregullorja e funksionimit të brendshëm të Bashkisë Klos, me qëllim që të mundësojë detyra të qarta dhe rregulla edhe për funksionimin e aktivitetit të ujësjellësit të qytetit.

-të krijohet regjistri i aktiveve të qëndrueshme ku të pasqyrohen të dhënat e nevojshme si; data e hyrjes, vlera e blerjes, vlera e shpenzimeve të mirëmbajtjes, amortizimi i akumuluar etj, sipas kërkesave të Kap.III-të të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Menjëherë

2. Sektori i të ardhurave dhe tarifave vendore :

a. Nga Bashkia Klos të merren masa dhe të ngrihen grupe pune, për të evidentuar të gjithë subjektet që kryejnë aktivitet privat dhe rezultati të krahasohet me Drejtorinë Rajonale Tatimore Peshkopi dhe sistemin e Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

b. Të hartojë paketën e llojeve të gjobave, masat respektive të tyre dhe duke i propozuar Këshillit Bashkiak vendosjen e masës së gjobës për çdo shkelje të cilat përbëjnë kundërvajtje administrative, siç përcaktohet në shkronjën (a) neni 6 të ligjit nr. 10.279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”.

c. Të hartojë planet vjetore për ushtrimin e kontrolleve sipas pikës 10 “Kontrolli tatimor”, të udhëzimit përbashkët të Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Financave nr. 655/1, datë 6.02.2007.

d. Nga zyra e taksave vendore ti dërgohet zyrtarisht sektorit të financës listat e debitorëve të vitit 2011 për 88 subjektet debitorë në vlerën prej 3.010,894 lekë, në zbatim të kërkesave të neneve 4/2, 17/3 dhe 34 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” ,dhe të raportohet periodikisht për ecurinë e vjeljes tyre, tek kryetari i Bashkisë.

e. Për subjekte debitorë të ndiqen procedurat ligjore duke ju dërguar Bankave urdhrat e bllokimit të llogarive në banka, bazuar në nenin 90 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë".

f. Për subjekte debitorë të fushës së transportit, ti dërgohen Drejtorisë Rajonale të Transportit Peshkopi, vendosja e bares siguruese (për mjetet) dhe Zyrës së Regjistrimit (për pasurinë e paluajtshme) bazuar në nenin 91 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë".

Menjëherë

3. Nga Policia Bashkiake të merren masat për :

a. Arkëtimin e 14 gjobave për **vlërën 63,000 lekë** të vendosura nga Policia Bashkiake sipas Aneksit nr. 3, bashkëlidhur Projektraportit të Auditimit.

b. Në bashkëpunim me Zyrën e Taksave, të evidentohen furgonat taksi të palicencuara dhe të bëhet regjistrimi i tyre duke llogaritur detyrimet nga viti 2011-2012, në të kundërtën të zbatohen sanksionet ligjore përkatëse.

c. Të merren masa që korrespondenca me Zyrën e Taksave Vendore të bëhet në mënyrë zyrtare e shkresore.

d. Të porositen dhe prodhohen blloqet e gjobave të Policisë Bashkiake me numër serial dhe deri në përgatitjen e tyre, fletë gjobat tu dërgohen zyrtarisht kundërvajtësve nëpërmjet zyrës së protokollit të Bashkisë Klos, sipas legjislacionit në fuqi.

Menjëherë

4. Zyra e Administrimit të Tokës, të kujdeset për administrimin e pronave deri në inventarizimin dhe regjistrimin tyre në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

Menjëherë

5. Të kryhen veprimet e duhura juridike dhe procedurat që kanë të bëjnë me kontratat e marrëdhënieve për qiranë e tokës me 6 qytetarët përkatësisht: [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] të cilëve në bazë të vendimeve të Këshillit Bashkiak u është dhënë me qira trualli, kjo sipas përcaktimeve në VKM nr. 529, datë 08.06.2011 "Për përcaktimin e kritereve të procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore" dhe udhëzimin për zbatimin e këtij vendimi, nr. 906, datë 21.11.2011, i Ministrisë së Ekonomisë Tregtisë dhe Energjetikës.

Menjëherë

6. Nga ana e Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik të Bashkisë Klos në bashkëpunim me Sektorin e Urbanistikës, ti kërkohet zyrtarisht Prokurorisë dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Burrel, ecuria në lidhje me kallëzimet penale për qytetarët të cilët kanë kryer ndërtime të paligjshme dhe në vlerësim të tyre të vazhdojnë procedurat e nevojshme ligjore.

Menjëherë

7. Të plotësohet dosja individuale e punës për punonjësën e Policisë Bashkiake [REDAKTUAR] me të gjithë dokumentacionin e munguar dhe konkretisht : librezën e punës, listën e notave, kontratën e punës dhe dokumentacionin e përcaktuar në Aneksin e I dhe II-^{të}, të VKM nr. 355, datë 07.07.2000 "Për organizimin e dosjes dhe regjistrimit personelit". Në të kundërtën, të pezullohet pagesa deri në plotësimin e tyre, duke bërë llogaritjet e duhura dhe ndërprerjen e marrëdhënieve të punës.

Menjëherë

8. Meqenëse Bashkia Klos, nuk ka njësi shpenzuese në varësi, shërbimi i auditimit të brendshëm të kryhet bazuar në kriteret e përcaktuara në VKM nr. 212, datë 30.03.2012 "Për miratimin e kriterëve për ngritjen e njërive të auditimit të brendshëm në sektorin publik".

Menjëherë

9. Të kryhet një studim për riorganizimin dhe rentabilitetin ekonomik të aktivitetit të ujësjellësit, duke e shoqëruar edhe me masat e mëposhtme;

- lidhjen e kontratave me konsumatorët familjarë dhe jo familjar për njohjen e detyrimeve përkatëse duke aplikuar edhe penalitete (kamat vonesa).

- prodhimin e faturave të ujit të pijshëm me numër serie duke u miratuar edhe në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe të regjistrohen në kontabilitet, si për sasinë e ujit të shitur dhe vlerën e paguar, duke nxjerrë debitorë personat të cilët nuk paguajnë, dhe të llogariten edhe kamat vonesat përkatëse apo deri në ndërprerjen e ujit të pijshëm.

- faturat e ujit të pijshëm të hartohen nga një person tjetër i cili nuk duhet të ketë lidhje edhe me grumbullimin e lekëve.

- të caktohet një inspektor i ujit të pijshëm.

- për administrimin e ujësjellësit të qytetit Klos, të respektohen edhe kërkesat e tjera të përcaktuara në VKM nr. 236, datë 10.05.1993 "Për administrimin e furnizimit me ujë për përdoruesit familjarë dhe jo familjarë", ndryshuar me VKM nr. 96, datë 21.02.1997; udhëzimi nr. 03, datë 28.07.2004 të ish-Ministrisë së Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit "Për administrimin e ujit të pijshëm" dhe legjislacioni në fuqi.

Në mbledhjen më të afërme të Këshillit Bashkiak.

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI.

Të merren masa e të kryhen kontabilizimi në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim për shpërblimin e dëmit me vlerë **3,009,913 lekë**, në mënyrë analitike si më poshtë:

1. Vlera prej **881,888 lekë**, nga 8 qytetarë të cilët nuk kanë paguar vlerën e qerasë së tokës, përkatësisht: ■ **162,000 lekë**; ■ **82,600 lekë**; ■ **337,600 lekë**; ■ **105,000 lekë**; ■ **230,000 lekë**; ■ **36,800 lekë**; ■ **16,000 lekë** dhe ■ në shumën **12,288 lekë**. Në kundërshtim me Kreun e III-të pikat 4 dhe 5 të VKM nr. 1712, datë 24.12.2008 "Për dhënien me qera ose enfiteozë të pasurive shtetërore".

Menjëherë

2. Vlera prej **756,620 lekë**, nga Subjekti ■ sh.p.k, punime të pakryera sipas preventivit dhe kontratës datë 2.3.2009, në objektin: "Rikonstruksion dhe zgjerim i rrugës Klos Fullqet".

Menjëherë

3. Vlera prej **363,810 lekë**, nga Subjekti ■ punime të pakryera sipas preventivit dhe kontratës datë 10.7.1009 në objektin: "Rikonstruksion i rrugës Bejnë - Klos".

Menjëherë

4. Vlera prej **328,500 lekë**, nga Media televizive ■ sh.p.k. për pagesa jo të rregullta për blerjet e vogla, në kundërshtim me Kreun e III-të neni 7, 8 dhe 10, të ligjit 6942, datë 25.12.1984 "Për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare" dhe me Kreun VI-të pika 2, germa c dhe ç, të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.

Menjëherë

5. Vlera prej **222,500 lekë**, nga firma [REDACTED], për pagesë jo të rregullt për blerjet e vogla, në kundërshtim me Kreun e III-të nenet, 7, 8 dhe 10, të ligjit 6942, datë 25.12.1984, “Për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare” dhe me Kreun VI-të pika 2, germa c dhe ç, të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Menjëherë

6. Nga ana Sektorit të ardhurave Klos, bazuar në nenin 70 pika 3 “ E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor”, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore”, për 7 Restorante në Bashkinë Klos, të nxirret njoftim për vlerësimet e xhiros, **për vlerën 135,000 lekë**.

Menjëherë

7. Vlera prej **134,405 lekë**, nga Subjekti [REDACTED] sh.p.k, punime të pakryera sipas preventivit dhe kontratës datë 10.2.1009 në objektin, ”Ndërtim ujësjellësi fshati Patin Klos”.

Menjëherë

8. Vlera prej **109,180 lekë**, për mos pagesën e ujit të pijshëm nga 19 lokale private në vlerën **80,480 lekë** dhe 28 konsumatorë familjarë në **vlerën 28,780 lekë**.

Menjëherë

9. Vlera prej **56,610 lekë**, nga Subjekti [REDACTED] sh.p.k, punime të pakryera sipas preventivit dhe kontratës datë 27.11.2008 në objektin, “Sistemim asfaltim, ndriçim rruga e Lagjes nr. 3, qyteti Klos”.

Menjëherë

10. Vlera prej **21,400 lekë**, nga [REDACTED] me detyrë ish-përgjegjësi i zyrës së taksave, për mos rakordim të 5 subjekteve ndërmjet regjistrisë të tatimpaguesve me zyrën e financës, për vitin 2009.

Menjëherë

B. MASA ADMINISTRATIVE

B1. Në zbatim të nenit 71, germa (ë) , të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 ” Për menaxhimin e sistemit të buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, për mos regjistrimin në kontabilitet të faturave të ujit të pijshëm dhe mos kryerjen e inventarit fizik të punonjësës që ka kryer detyrën e faturist-arkëtares së ujit të pijshëm, i kërkojmë nëpunësit të parë autorizues, Kryetarit të Bashkisë Klos, z. [REDACTED] **që të ndëshkojë administrativisht duke aplikuar gjobë në masën e 1 page mujore**, në vlerat e cituara më poshtë, për këta persona:

1. [REDACTED] ish-përgjegjësi i sektorit të financës, për periudhën 2004- deri në muajin shtator 2011, aktualisht sekretar i këshillit bashkiak, Klos në vlerën **43,142 lekë**.

2. [REDACTED] përgjegjësi i ujësjellësit, në vlerën **20.700 lekë**.

Për shkeljet e mëposhtme:

-nuk njohin gjendjen e aktivitetit të ujësjellësit të qytetit Klos, në lidhje me vlerën e ujit të shitur dhe arkëtuar, duke mos kryer inventarizimin fizik të faturave të ujit të pijshëm, si gjatë periudhës apo në fund të 3 viteve 2009, 2010 dhe 2011, në kundërshtim me nenin 7-Inventari i aktiveve dhe detyrimeve, të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”.

-për nxjerrjen dhe raportimin e pasaktë të Pasqyrave Financiare (bilanceve vjetore), duke mos përfshirë në detyrime edhe vlerën e faturave të pa likuiduara të ujit të pijshëm, për 3 vitet 2009, 2010 dhe 2011, në kundërshtim me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", neni 5, - Mbajtja e kontabilitetit, neni 6 - Evidencat mbështetëse, neni 9 - Respektimi i standardeve kontabël dhe nenin 10 - Bazat dhe parimet mbështetëse.

-nuk kanë kryer asnjëherë kontroll për administrimin e të ardhurave nga uji i pijshëm, duke shkelur nenin 44 të ligjit nr. 6942, datë 25.12.1994 "Për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare".

-nuk është hapur dhe azhurnuar, rast pas rasti analiza (partitari) për faturimin dhe arkëtimin e të ardhurave nga uji i pijshëm, por ato janë mbajtur në total në zërin e të ardhurave, në kundërshtim me VKM nr. 783, datë 22.11.2006 "Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël", Kap I,-Mbajtja e kontabilitetit -pika 2 shkronja (c) -Dokumentet e kontabilitetit", pika 2.3 -Rregullat e përgjithshme të mbajtjes së librave dhe dokumenteve të tjera të kontabilitetit.

B.2. Bazuar në ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", neni 15, ndryshuar me nenin 2 të ligjit nr. 9826, datë 01.11.2007, për shkelje të nenit 7; pikat, 1, 3, 4, 17, 18 dhe 19 të UKM nr. 3, datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" i ndryshuar; pikat, 8, 8/1, 8/2 dhe 10 të kreut II-të dhe pikat 4, 5 të kreut III-të, të UKM nr. 2, datë 13.05.2005 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit", **i propozohet:** Kryeinspektorit të Inspektoratit Ndërtimor dhe Urbanistik, pranë Bashkisë Klos, që **të ndëshkojë administrativisht duke aplikuar gjobë për personat e mëposhtëm:**

1. ■ në cilësinë e mbikëqyrëses së punimeve, me licencë MK 1548 datë 08.06.2008, **gjobë në masën 100,000 lekë**, pasi nga mos kontrolli ka rezultuar se janë raportuar punime të pakryera në vlerën **756,620 lekë**, sipas preventivit dhe kontratës datë 2.3.2009, në objektin: "Rikonstruksion dhe zgjerim i rrugës Klos Fullqet".

2. ■ në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve me licencë MK 1013, datë 27.06.2006, **gjobë në masën 50,000 lekë**, pasi nga mos kontrolli ka rezultuar se janë raportuar punime të pakryera në vlerën **363,810 lekë**, sipas preventivit dhe kontratës datë 10.7.1009, në objektin: "Rikonstruksion i rrugës Bejnë-Klos".

3. ■ në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve, me licencë MK 1463 datë 01.02.2008, **gjobë në masën 50,000 lekë** pasi nga mos kontrolli ka rezultuar se janë raportuar punime të pakryera në vlerën **134,405 lekë**, sipas preventivit dhe kontratës datë 10.02.2009 në objektin: "Ndërtim ujësjellësi fshati Patin-Klos".

B.3. Në zbatim të nenit 72 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" të ndryshuar, nenin 25, pika 3, germa "b", të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil" dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2007, Kreu X, i ndryshuar dhe kontratës individuale të punës neni 13 germa (a), të kërkohet nga APP që, për shkeljet e konstatuara në zhvillimin e procedurave të prokurimeve publike të zhvilluar në periudhën nga data 01.01.2009-31.12.2011, ti rekomandojë autoritetit kontraktor që të mare masën disiplinore "**Vërejtje me paralajmërim**" **për 3 personat e mëposhtëm:**

1. ■ me detyrë Përgjegjës i Sektorit Administrimit të tokës, në cilësinë e kryetarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, për shkeljet e konstatuara në 7 tendera të detajuara më poshtë.

2. ■ me detyrë përgjegjës i sektorit të urbanistikës dhe shërbimeve, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për shkeljet e konstatuara në 7 tendera të detajuara më poshtë.

-në 5 tendera të zhvilluar në vitin 2009, me objekt “Ndërtim ujësjellësi në fshatin Patin”, Rikonstruksion dhe zgjerimi i rrugës Klos Fullqet”, “Rikonstruksion dhe zgjerimi i rrugës Bëjnë”, “Ndërtim i rrugës Cërujë Kukatin Plezhë”, “Ndërtim rrugësh rurale në fshatrat e Bashkisë Klos”, - në 2 tendera të zhvilluar në vitin 2011 me objekt “Rikonstruksion kanali vaditës Dars Klos Mat”, “Ndërtim rrugësh rurale në fshatrat e Bashkisë Klos”,

3. ■ me detyrë Inspektor Shërbimesh, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, për shkeljet e konstatuara në 5 tenderat si më poshtë:

-në 3 tendera të zhvilluar në vitin 2009, me objekt “Rikonstruksion dhe zgjerimi i rrugës Bëjnë”, “Ndërtim i rrugës Cërujë Kukatin Plezhë”, “Ndërtim rrugësh rurale në fshatrat e Bashkisë Klos”,

-në 2 tendera të zhvilluar në vitin 2011 me objekt “Rikonstruksion kanali vaditës Dars Klos Mat”, “Ndërtim rrugësh rurale në fshatrat e Bashkisë Klos”.

Ndërsa mangësitë për secilin tender në mënyrë të përmbledhur paraqiten si më poshtë:

1. Në tenderin e zhvilluar më datën 09.01.2009, me procedurë tenderi i hapur, me objekt “Ndërtim ujësjellësi fshati Patin”, shpallur fitues bashkimi i operatorëve ekonomikë ■ me vlerë kontrate 16,661,252 lekë, u konstatuan mangësitë e mëposhtme:

Operatori ekonomik ■ sh.p.k.

-në listëpagesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi nuk rezultojnë 2 drejtuesit teknik, në kundërshtim me kërkesat e veçanta për kualifikim, në pikën 2, të pikës 4,

-ka paraqitur “punime të ngjashme”, si bashkim operatorësh, por nuk ka paraqitur aktmarrëveshjen dhe nuk mund të përcaktohet vlera e punimeve që ka kryer shoqëria ■

-në zërat e punës të kryera për realizimin e kësaj kontrate nuk rezultojnë të jetë zëri i punës “ndërtim depo uji 100 m³”, në kundërshtim me kriteret për kualifikim.

- *Operatori ekonomik ■*

-në listëpagesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi për vitin 2008, nuk rezultojnë 2 drejtuesit teknik, në kundërshtim me kriteret për kualifikim.

-nga dy ofertuesit e paraqitur në tender, oferta e bashkimit të operatorëve ekonomikë “R. & I.” nuk plotëson kriteret për kualifikim.

2. Në tenderin e zhvilluar më datën 30.01.2009, me procedurë tenderi i hapur me objekt “Rikonstruksion e zgjerimi i rrugës Klos Fullqet”, shpallur fitues bashkimi i operatorëve ■ me vlerë kontrate 47,565,396 lekë, u konstatuan mangësitë e mëposhtme:

Operatori ekonomik ■ sh.p.k.

- nuk ka paraqitur kontratën e punës, për 3 punonjës të stafit drejtues, në kundërshtim me kërkesat për kualifikim të kërkuar nga autoriteti kontraktor.

-në listëpagesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi për periudhën janar-qershor 2008, nuk rezultojnë 2 drejtuesit teknik, të deklaruar në stafin drejtues.

-nuk ka paraqitur kontratën të lidhur me komunën “Dajt” për “punime të ngjashme” në kundërshtim me kriteret e veçanta për kualifikim.

- nuk ka paraqitur dokumentacion të “pronësie nga qiradhënësi” për marrje me qira fabrikë asfalto betoni

-Operatori ekonomik [REDACTED] nuk ka paraqitur dokumentacionin e nevojshëm për “punime të ngjashme”.

3. Në tenderin e zhvilluar me datën 15.5.2009, me procedurë tender i hapur me objekt **“Rikonstruksion dhe zgjerimi i rrugës Bejnë”**, shpallur fitues bashkimi i operatorëve ekonomikë [REDACTED] me vlerë kontrate 45,745,282 lekë, u konstatuan mangësitë e mëposhtme:

- në aktmarrëveshjen e bashkëpunimit, bashkimi i operatorëve ekonomik [REDACTED] nuk kanë përcaktuar elementët konkretë që do të kryejë secili nga anëtarët e grupit.

- në listëpagesën e sigurimeve shoqërore të operatori ekonomik [REDACTED] nuk rezultojnë dy drejtuesit teknik.

-ka paraqitur dokumentacionin për “punë të ngjashme”, me datë lëshimi në periudhën mbi 3 vjet.

-operatori ekonomik [REDACTED] nuk ka paraqitur dokument nga administrata tatimore, për shlyerjen e detyrimeve të sigurimeve shoqërore për vitin 2008

- operatori ekonomik [REDACTED] në listëpagesën e sigurimeve shoqërore për vitin 2008 dhe 2009, nuk rezulton të ketë shlyer detyrimet për sigurimet shoqërore e shëndetësore për dy drejtuesit teknik.

4. Në tenderin e zhvilluar me datë 15.05.2009, me procedurë tender i hapur, me objekt **“Ndërtim i rrugës Cërujë Kukatin Plezhë”**, shpallur fitues bashkimi i operatorëve ekonomikë [REDACTED], me vlerë të kontratës 17,553,974 lekë, u konstatuan mangësitë e mëposhtme:

-në kontratën e bashkëpunimit bashkimi i operatorëve ekonomikë [REDACTED] nuk janë specifikuar elementët konkretë të punës që do të kryejë secili nga anëtarët.

-operatori ekonomik [REDACTED] nuk ka paraqitur licencën profesionale për ekzekutimin e punëve të kontratës.

-operatori ekonomik [REDACTED] nuk ka paraqitur licencën profesionale të shoqërisë.

-bashkimi i operatorëve ekonomikë [REDACTED] në kontratën e bashkëpunimit të lidhur me datë 06.05.2009, nuk janë specifikuar elementët konkretë të punës që do të kryejë secili nga anëtarët.

-operatori ekonomik [REDACTED] nuk ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar për kapacitetet teknike, “makineritë”.

5. Në tenderin e zhvilluar me datën ,08.05.2009, me procedurë tender i hapur, me objekt **“Ndërtim rrugësh rurale në fshatrat e Bashkisë Klos ”**, shpallur fitues operatori ekonomik [REDACTED] me vlerë të kontratës 4,952,352 lekë, u konstatuan këto mangësi;

-operatori ekonomik [REDACTED] nuk ka paraqitur dokument të vlefshëm për plotësimin e kriterit “Disponimi i kapaciteteve teknike”, pasi ka paraqitur kontratë qiraje të pa vlefshëm për këtë tender.

-dokumentacioni administrativo ligjor origjinal i fituesit, [REDACTED] është noterizuar me datë 11 korrik 2009, ose 25 ditë pas lidhjes së kontratës.

6. Në tenderin e zhvilluar i hapur më datën 06.06.2011, me procedurë “Kërkesë për propozim” me objekt **“Rikonstruksion kanali vaditës Dars-Klos-Mat”**, shpallur fitues bashkimi i operatorëve ekonomikë [REDACTED] me vlerë kontrate 10.810,510 lekë, u konstatua si mangësi se, dy anëtarët e grupit nuk kanë paraqitur kualifikimet dhe eksperiencën e personelit kryesor që do realizojë punimet.

7. Në tenderin e zhvilluar më datën 06.06.2011, me procedurë “Kërkesë për propozim”, me objekt **“Ndërtim rrugësh rurale në fshatrat e Bashkisë Klos”**, shpallur fitues bashkimi i operatorëve

ekonomikë [REDAKTUAR] me vlerë kontrate 7,635,696 lekë, u konstatuan si mangësi pasi Bashkimi i operatorëve ekonomikë [REDAKTUAR] në aktmarrëveshjen e lidhur me datë 14.04.2011 nuk janë përcaktuar elementët konkretë të punës që do të kryejë secili anëtar i grupit.

C. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenin 25, pika 3, germat “b” dhe “ç” të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”; pika 1, shkronjat “b” dhe “ë”, të VKM nr. 306, datë 13.06.2000 “Për disiplinën në shërbimin civil”; nenet 143 dhe 144 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “ Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar dhe Kontratës individuale të punës nenet 13 dhe 14, bazuar në nenin 44 të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, i ndryshuar, i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Klos, të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore, **për 9 punonjësit** si më poshtë:

a. “Vërejtje me paralajmërim”, bazuar në Kontratën individuale të punës neni 13 germa (b), për 4 punonjësit si më poshtë:

1. [REDAKTUAR] me detyrë Inspektor i biznesit të vogël, për vitin 2011 e në vazhdim, pasi;

- ka lejuar që për vitin 2011 të mos paguajnë asnjë kësht 29 subjekte të Biznesit të Vogël në vlerën 1,201,700 lekë, sipas listës në Aneksin Nr. 6, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.
- nuk ka aplikuar gjoba në masën 5-25 për qind , ndaj subjekteve të cilët nuk kanë paguar në afat detyrimet tatimore, në kundërshtim me nenin 114 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 ” Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”.
- nuk i ka dërguar Bankave urdhrat e bllokimit të llogarive për 29 subjektet debitorë të biznesit të vogël, në vlerën 1,201,700 lekë, në kundërshtim me nenin 90 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 ”Për Procedurat Tatimore”.
- nuk ka kërkuar vendosjen e bares siguruese, për 29 subjektet debitorë të biznesit të vogël në vlerën 1,201,700 lekë, përkatësisht: Drejtorisë Rajonale të Transportit (për mjetet) dhe Zyrën së Regjistrimit të Paluajtshme (për pasurinë e paluajtshme), në kundërshtim me nenin 91 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”.
- në cilësinë e anëtarit të komisionit për zbatimin e procedurave të faljes, nuk u ka dërguar subjekteve të biznesit të vogël Akt-faljet, në kundërshtim me Kap II.1- Falja e detyrimeve tatimore, pika 3 germa (a) të udhëzimit MF nr. 12, datë 18.5.2011 “Për Procedurat e zbatimit të ligjit nr. 10 418, datë 21.4.2011 “Për legalizimin e kapitalit dhe faljen e një pjese të borxhit tatimor dhe doganor”.

2. [REDAKTUAR] ish-inspektor i biznesit të vogël, për 2 vitet 2009-2010, aktualisht administrator në zyrën e ndihmave ekonomike, pasi:

- Nuk ka ushtruar kontrole për mbajtjen e saktë të librave dhe mbajtjen e xhiros, në kundërshtim me nenin 15 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”.
- Nuk ka aplikuar gjoba në masën 5-25 për qind, ndaj subjekteve të cilët nuk kanë paguar në afat detyrimet tatimore, në kundërshtim me nenin 114 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 ” Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”.
- Nuk i ka dërguar Bankave urdhrat e bllokimit të llogarive për subjektet debitorë të biznesit të vogël, në kundërshtim me nenin 90 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 ”Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

-Nuk ka kërkuar vendosjen e bares siguruese, për subjektet e biznesit të vogël debitorë, përkatësisht: Drejtorisë Rajonale të Transportit (për mjetet) dhe Zyrës së Regjistrimit të Paluajtshme (për pasurinë e paluajtshme), në kundërshtim me nenin 91 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë".

3. ■■■■■ me detyrë përgjegjës i administrimit të tokës, për;

- mos zbatimin e rekomandimit të KLSH-së, dërguar me shkresën nr. 785/5, datë 17.3.2009, në lidhje me rakordimin dhe saktësimin e fondit të tokës ZVRPP Mat, me sipërfaqen e tokës të ndarë që ju përket 13 fshatrave në administrim të Bashkisë, Klos.

-mos plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm të objekteve ndërtimore që aktualisht janë të pa regjistruar, në ZVRPP, siç përcaktohet në VKM nr. 500, datë 14.08.2001 "Për inventarizimin e pasurisë paluajtshme shtetërore dhe transformimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore pyjet dhe kullotat" dhe UKM nr. 3, datë 18.07.2002 dalë në zbatim të tij.

- mos përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm dhe mos kalimin në Këshillin Bashkiak të aseteve për Pyjet dhe Kullotat, siç përcaktohet në VKM nr. 880, datë 20.6.2008 "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave, pyjeve dhe kullota, që do të transferohen në pronësi të njësisë së qeverisjes vendore, Bashkisë Klos, të Qarkut Dibër".

- mos kontroll të shfrytëzimit të tokave në territorin e Bashkisë, mos lidhjen e 8 kontratave për tokat e dhëna me qira nga Këshilli Bashkiak Klos, me pasojë krijimin e të ardhurave të munguara në shumën **881,888 lekë**, në kundërshtim me Kreu III^{te}, pikat 4 dhe 5 të VKM nr. 1712, datë 24.12.2008 "Për dhënien me qira ose enfiteozë të pasurive Shtetërore" i ndryshuar.

4. ■■■■■ specialiste e kontabilitetit, për periudhën nga viti 2004 e në vazhdim.

Për shkeljet e mëposhtme:

-nuk njohin gjendjen e aktivitetit të ujësjellësit të qytetit Klos, në lidhje me vlerën e ujit të shitur dhe arkëtuar, duke mos kryer inventarizimin fizik të faturave të ujit të pijshëm, si gjatë periudhës apo në fund të 3 viteve 2009, 2010 dhe 2011, në kundërshtim me nenin 7-Inventari i aktiveve dhe detyrimeve, të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare".

-për nxjerrjen dhe raportimin e pasaktë të Pasqyrave Financiare (bilanceve vjetore), duke mos përfshirë në detyrime edhe vlerën e faturave të pa likuiduara të ujit të pijshëm, për 3 vitet 2009, 2010 dhe 2011, në kundërshtim me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", neni 5, - Mbajtja e kontabilitetit, neni 6 - Evidencat mbështetëse, neni 9 - Respektimi i standardeve kontabël dhe nenin 10 - Bazat dhe parimet mbështetëse.

-nuk kanë kryer asnjëherë kontroll për administrimin e të ardhurave nga uji i pijshëm, duke shkelur nenin 44 të ligjit nr. 6942, datë 25.12.1994 "Për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare".

-nuk është hapur dhe azhurnuar, rast pas rasti analiza (partitari) për faturimin dhe arkëtimin e të ardhurave nga uji i pijshëm, por ato janë mbajtur në total në zërin e të ardhurave, në kundërshtim me VKM nr. 783, datë 22.11.2006 "Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël", Kap I,-Mbajtja e kontabilitetit -pika 2 shkronja (c) -Dokumentet e kontabilitetit", pika 2.3 -Rregullat e përgjithshme të mbajtjes së librave dhe dokumenteve të tjera të kontabilitetit.

b. "Kalim në një detyrë të një niveli apo klasë më të ulët, për një periudhë 1 vjeçare", bazuar në Kontratën individuale të punës neni 13 germa (ç), për 3 personat e mëposhtëm:

1. ■■■■■ me detyrë P/Sektori i të Ardhurave për periudhën nga muaji shtator 2011 e në vazhdim, pasi ;

-nuk ka ndarë detyrat me shkrim dhe numrin e subjekteve që do të mbajë, përgjegjësi i sektorit dhe inspektori i taksave, në kundërshtim me nenet 16 dhe 17 të Rregullores brendshme "Për

organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës së bashkisë”, miratuar me Vendimin e Këshillit Bashkiak Klos, nr. 21, datë 21.11.2011.

-për mos evidentim të saktë të gjendjes së subjekteve debitorë më datën 31.12.2011, pasi në listën e debitorëve që ju dorëzua grupit të auditimit të KLSH, më datën 20.06.2012, paraqiten vetëm 48 subjekte debitorë në vlerën 2.377.494 lekë. Ndërsa pas rakordimit të Regjistrave të tatimpaguesve, rezultojnë debitorë 100 subjekte në vlerën 5,465,644 lekë, duke raportuar më pak 52 subjekte në vlerën 1,410,150 lekë.

-në cilësinë e kryetarit të komisionit për zbatimin e procedurave të faljes, nuk u ka dërguar subjekteve Akt-faljet, në kundërshtim me Kap II.1- Falja e detyrimeve tatimore, pika 3 germa (a) të udhëzimit MF nr. 12, datë 18.5.2011“Për Procedurat e zbatimit të ligjit nr. 10 418, datë 21.4.2011 ”Për legalizimin e kapitalit dhe faljen e një pjese të borxhit tatimor dhe doganor”.

-nuk ka hapur regjistrat e tatimpaguesit për evidentimin dhe vjeljen e taksës të mjeteve të transportit dhe për 16 subjektet e biznesit të madh.

-nuk i ka dërguar Bankave urdhrat e bllokimit të llogarive për periudhën 88 subjektet debitorë më datën 31.12.2011 në vlerën 3,010,894 lekë, duke shkelur nenin 90 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 ”Për Procedurat Tatimore”.

-nuk ka kërkuar vendosjen e bares siguroese, për 88 subjektet debitorë më datën 31.12.2011, në vlerën 3,010,894 lekë, përkatësisht: Drejtorisë Rajonale të Transportit (për mjetet) dhe Zyrës së Regjistrimit të Paluajtshme (për pasurinë e paluajtshme),duke shkelur nenin 91 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008” Për Procedurat Tatimore”.

-për marjen me mangësi të detyrës datë 20.10.2011, pasi dokumentacioni është marë me numër Dosjesh në total dhe jo me inventar e numër fletësh për secilën dosje dhe Regjistër të tatim paguesve, në kundërshtim me pikat 20 dhe 21 të VKM nr. 360, datë 14.07.2000” Për lirimin nga shërbimi civil”.

2. ■■■■■ me detyrë ish-përgjegjës i policisë bashkiake, për periudhën e vitit 2009-2010 dhe nga 9 mujori 2011 e në vazhdim, në Inspektoratin ndërtimor urbanistik të bashkisë.

3. ■■■■■ me detyrë polic.

Për shkeljet e mëposhtme;

-nuk kanë verifikuar pajisjen me liçencë të tregëtarëve dhe personave të tjerë që meren me veprimtari shitblerje dhe subjekteve që ushtrojnë veprimtari në transportet rrugore, në kundërshtim me kërkesa të nenit 8, pikat 9 dhe 15 të ligjit nr. 8224, datë 15.5.1997, ndryshuar me ligjin nr. 8335, datë 23.04.1998 “Për organizimin dhe Funksionimin e Policisë të Bashkisë dhe të Komunës”.

-për mos kontroll dhe mos detyrimin për regjistrim të subjekteve të transportit dhe furgonat taksi, pasi nga verifikimi rezultuan 7 Fugona pa u regjistruar.

-për mungesë bashkërendimi me sektorin e taksave vendore dhe për pasojë deri më datën 30.6.2012, nuk kanë paguar detyrimet 88 subjekte për 3,010,894 lekë.

-për mos nisjen e procedurave ligjore për ekzekutimin e 14 gjobave dhe mos dërgimin për regjistrimin e tyre në kontabilitet në vlerën 63,000 lekë.

-për mos propozimin dhe miratimin në këshillin bashkiak të paketës me llojet dhe masën e gjobës për çdo shkelje të cilat përbëjnë kundërvajtje administrative, në kundërshtim me nenin 6 të ligjit nr. 10279,datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”.

c.“**Zgjidhje të kontratës së punësimit**”, bazuar në nenet 143 dhe 144 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar dhe Kontratës individuale të punës nenet 13 dhe 14, **për 2 personat e mëposhtëm:**

1. ■■■■■ me detyrë ish- P/Sektorin i të Ardhurave për vitet 2009-2010 dhe 9/ Mujorin 2011, aktualisht që nga muaji tetor 2011 e në vazhdim me detyrën e auditit të brendshëm publik në bashki, pasi ;

a. Emërimi në detyrën e audituesit të brendshëm të ■■■■■, pa u pajisur me çertifikatën "Auditues i brendshëm në sektorin publik", është bërë në kundërshtim me nenin 19 "Punësimi" të ligjit nr. 9720, datë 23.4.2007 "Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik", ndryshuar me ligjin nr. 10318, datë 16.9.2010.

b. *Për periudhën kur ka qenë në detyrën e P/ të Sektorit të Ardhurave.*

-Për mos ndjekje të procedurave ligjore në lidhje me pagesën e detyrimeve tatimore për vitin 2011, duke mbetur debitorë 88 subjekte në vlerën 3,787,644 lekë, ose mbi 50 për qind të parashikimit.

-Nga 127 subjekte që kanë ushtruar aktivitetin për vitin 2011, 42 prej tyre ose 30 për qind nuk kanë paguar asnjë këst detyrimi në vlerën 2,687,344 lekë.

-Ka lejuar që për 3 vitet 2009-2011, të mos paguajnë asnjë leke detyrim tatimor 17 subjekte në vlerën 2.472,894 lekë, nga të cilat 3 prej tyre nuk kanë paguar që 3 vjet - 1.036,300 lekë dhe 14 subjekte nuk kanë paguar që 2 vjet -1,436,594 lekë.

-Për mos rakordimin e veprimeve në Regjistrat e subjekteve fizike e juridike me të dhënat e arkëtimeve në zyrën e financës, për pasojë 5 subjekte nuk kanë paguar në buxhetin e Bashkisë Klos vlerën prej 21,400 lekë.

-Nuk ka hapur regjistra për evidentimin dhe vjeljen e taksës për tokën bujqësore, për taksën e ndërtesës, tarifat e pastrimit për familjarët, mjetet e transportit dhe 15 subjekteve të Biznesit të Madh.

-Nuk ka hartuar planin e kontrollit dhe nuk ka ushtruar kontrole në kundërshtim me pikën 10-Kontrolli tatimor, të udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 655/1, datë 06.02.2007 "Për përcaktimin e uniformitetit të standardeve procedurale dhe të raportimit të sistemit të taksës vendore".

-Nuk i ka dërguar Bankave urdhrat e bllokimit të llogarive për 88 subjektet debitorë në vlerën 3,010,894 lekë, duke shkelur nenin 90 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë".

-Nuk ka kërkuar vendosjen e bares siguroese, për 88 subjektet debitorë në vlerën 3,010,894 lekë, përkatësisht: Drejtorisë Rajonale të Transportit (për mjetet) dhe Zyrës së Regjistrimit të Paluajtshme (për pasurinë e paluajtshme), duke shkelur nenin 91 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë".

-Nuk ka ndarë detyrat me shkrim dhe numrin e subjekteve që do të mbajë, përgjegjësi i sektorit dhe inspektori i taksave, në kundërshtim me nenet 16 dhe 17 të Rregullores brendshme "Për organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës së bashkisë", miratuar me Vendimin e këshillit bashkiak Klos, nr. 21, datë 21.11.2011.

-Për dorëzimin me mangësi të detyrës datë 20.10.2011, pasi dokumentacioni është dorëzuar me numër Dosjesh në total dhe jo me inventar e numër fletësh për secilën dosje dhe Regjistër të tatim paguesve, në kundërshtim me pikat 20 dhe 21 të VKM nr. 360, datë 14.07.2000 "Për lirimin nga shërbimi civil".

2. ■■■■■ me detyrë faturiste-arkëtare e ujësjellësit për gjithë periudhën, për shkeljet ligjore të mëposhtme:

-Për mos administrimin e aktivitetit të ujësjellësit, mos kryerjen e faturimeve dhe rakordimeve për ç' do muaj, mos bërjen e bilancit për sasinë e ujit të prodhuar që duhej faturuar me arkëtimin

faktik, mos dorëzimin e faturave të papaguara në zyrën e financës, mos kryerjen e rakordimit dhe inventarit fizik , mos pasqyrimi në kontabilitet të aktivitetit të ujësjellësit, mos mbajtja e librit të arkës, mangësi të cilat janë bërë shkak për keq menaxhim të pasurisë shtetërore dhe lënie jashtë kontrollit shtetëror të aktivitetit të ujësjellësit të qytetit Klos.

-Hartimi i faturave të ujit të pijshëm dhe grumbullimi me lekë në dorë nga qytetarët për gjithë periudhën e audituar, është kryer nga i njëjti person, faturistja ████████ në kundërshtim me nenin 5 të ligjit nr. 6942, datë 25.12.1984 "Për administrimin, ruajtjen, dokumentimin e vlerave materiale e monetare".

-Bllloqet e faturimit të ujit të pijshëm nuk mbaheshin dhe administroheshin si letra me vlerë, në arkë ose magazinë, në kundërshtim me nenin 43 të ligjit nr. 6942, datë 25.12.1984 "Për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare".

-Nuk ka zbatuar VKM nr. 236, datë 10.05.1993 "Për administrimin e furnizimit me ujë për përdoruesit familjarë dhe jo familjarë", ndryshuar me VKM nr. 96, datë 21.02.1997 dhe udhëzimi nr. 03, datë 28.07.2004 të ish-Ministrit të Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit "Për administrimin e ujit të pijshëm".

- Nga mos kontrolli rezulton se 47 konsumatorë nuk kanë paguar detyrimet e ujit të pijshëm në vlerën 109,180 lekë, nga të cilat 19 lokale private në vlerën 80,480 lekë dhe 28 konsumatorë familjarë në vlerën 28,780 lekë.

Shënim: Auditimi u krye nga audituesit Niko Nako, Piro Imeraj dhe Milo Pano. Më tej u shqyrtua nga Kryeaudituesi i Departamentit, Drejtori i Departamentit Pullumb Beqiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Kontrollit të Cilësisë Ermal Yzeiraj, si dhe u verifikua si praktikë nga Drejtori i Përgjithshëm Helga Vukaj.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT